



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/109  
Datë: 02.07.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 korrik 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen procesverbalet nga mbledhjet; 101, 102, 103, 104 dhe 105 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 02/109  
Datë: 02.07.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 korrik 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 08/138, i datës 22 mars 2017.
2. Obligohet Ministria e Administratës Publike dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/109  
Datë: 02.07.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 korrik 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 07/14, të datës 15.11.2017, me të cilin është themeluar Komisioni i veçantë i shkallës së dytë i Qeverisë (Komisioni i Ankesave) për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesat e aplikuesve të pakënaqur me vendimet e Komisionit për Njohjen e Statusit të ish të Dënuarve dhe të ish të Përndjekurve Politikë

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 2. e Vendimit Nr. 07/14, të datës 15 nëntor 2017, si në vijim:  
z. Hamdi Gërvalla, i propozuar nga Shoqata e të Burgosurve Politikë, emërohet anëtar i Komisionit të Ankesave, e zëvendëson z. Binak Ulajn.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Komisioni i Ankesave, Komisioni për Njohjen e Statusit të ish të Dënuarve dhe të ish të Përndjekurve Politikë, si dhe institucionet tjera kompetente.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/109  
Datë: 02.07.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr. 25/14 Korrik 2016), duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 korrik 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, për emërimin e Kryesuesit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës këta kandidatë:
  - 1.1. Petrit Pepaj;
  - 1.2. Naim Sahiti.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin, bashkë me biografitë e kandidatëve të propozuar, t'ia procedojë për shqyrtim dhe emërim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 05/109  
Datë: 02.07.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 30 pika 3. të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 korrik 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa për rregullimin e ndarjeve buxhetore të organizatës buxhetore Zyra e Kryeministrit (kodi 104), sipas nenit 30.3 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
2. Në nën-programin Kabineti i Kryeministrit (kodi 10700) shuma prej 230,000.00 euro transferohet nga kategoria e shpenzimeve të Subvencioneve dhe Transfereve në kategorinë e shpenzimeve të Mallrave dhe Shërbimeve.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/109  
Datë: 02.07.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 19 të Ligjit Nr. 05/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116; Nr. 04/L-194; Nr.05/L-063, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 korrik 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Raporti i konsoliduar vjetor për funksionimin e sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Subjektet e Sektorit Publik të Kosovës për vitin 2018.
2. Obligohen të gjitha Subjektet e Sektorit publik që të marrin masat për adresimin e çështjeve për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike si më poshtë:
  - 2.1. Zbatojnë Ligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike në praktikë;
  - 2.2. Rishikojnë funksionin e zyrtarit kryesor financiar sipas kërkesave të nenit 7 dhe 33 të Ligjit për KBFP;
  - 2.3. Të siguroje pavarësinë dhe burime të mjaftueshme bazuar në nenin 21 dhe 23 të Ligjit të KBFP-së.
  - 2.4. Të plotësojnë njësitë e auditimit të brendshëm sipas kërkesave të nenit 22 të Ligjit të KBFP dhe Rregullores (QRK) Nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik.
  - 2.5. Zbatojnë me kohë rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm;
  - 2.6. Zbatojnë llogaridhënien menaxheriale duke përfshirë delegimin e autoritetit vendimmarrës, analizën dhe menaxhimin e rrezikut bazuar në rregulloren për menaxhim financiar e kontroll 01/2019.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/109  
Datë: 02.07.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 korrik 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Plani i Reagimit për Menaxhimin e Fluksit të Mundshëm të Migrantëve, Refugjatëve dhe Aplikuesve.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 08/109  
Datë: 02.07.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën nr. prot. 2248, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 korrik 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet komisioni për vlerësimin dhe propozimin e tarifave të përgjithshme për shfrytëzimin e lëndës së mbrojtur me të drejtën e autorit nga operatorët kabllorë.
2. Komisioni ka këtë përbërje:
  - 2.1. Dy përfaqësues nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - kryesues;
  - 2.2. Një përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit;
  - 2.3. Një përfaqësues nga Ministria e Financave, dhe
  - 2.4. Një përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik.
3. Obligohet komisioni që në pajtim me ligjin dhe me praktikat më të mira të vlerësoj dhe propozoj tarifat për Ministrin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i cili të njëjtat i paraqet për aprovim në Qeverinë e Kosovës.
4. Për nevojat e tij, komisioni mund të kërkoj mbështetje dhe ndihmë nga institucionet tjera të vendit dhe të angazhoj ekspertë të fushës nga brenda apo jashtë vendit.
5. Obligohet komisioni që propozimin për tarifa në formë të shkruar ta bëjë brenda afatit prej tre muajve nga dita e nënshkrimit të këtij vendimi, në varësi të angazhimeve komisioni ka afat shtesë edhe për tre muaj për dorëzimin e propozimit.
6. Obligohet MKRS të mbuloj shpenzimet për angazhimin eventual të ekspertëve.
7. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë. MKRS shërben si sekretariat i Komisionit.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
**Ramush HARADINAJ**  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 09/109  
Datë: 02.07.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.15/2017, me Rregulloren Nr.16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e MAPL-së, me nr. prot. 454-59/6, të datës 28.06.2019, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 korrik 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet propozimi për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës autorizimin për nënshkrimin e Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Financave, dhe Zvicrës përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) mbi Programin "Decentralizimi dhe Mbështetja Komunale (DEMOS) Faza II".
2. Qeveria e Republikës së Kosovës i rekomandon Presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi, në përputhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

  
**Ramush HARADINAJ**  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/109  
Datë: 02.07.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 korrik 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M   P R E L I M I N A R**

1. Miratohet shpronësimi me interes publik të pronave të paluajtshme ish shoqërore të P.SH. Auto-Prishtinë, ish Hoteli "VICTORY" për nevojat e Policisë së Kosovës, Zona Kadastrale: Prishtinë, Komuna Prishtinë, sipas tabelës të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, e cila tabelë është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi, apo cilës do pjesë të tij, kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë